



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:043224

Datë: 16.02.2024

Numri i dokumentit: 05340669

CPP.nr.11/14

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Izet Gërguri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit SH.A. KUR “M...” J.S.C. me seli në Mitrovicë, kundër debitorit A.Z nga Vushtrria, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat A.M në Vushtrri, P.nr.03/24 të datës 04.01.2024, jashtë seancës, me datën 16.02.2024, e mori këtë këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT i bazuar prapësimi i debitorit A.Z nga Vushtrria ashtu që SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri përmbarimor P.nr.03/24 të datës 04.01.2024, i lejuar nga Përmbaruesi Privat A.M në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përkatësisht për 119,89 € për periudhën kohore prej 01.01.2022-31.12.2022 për shkak të parashkrimit, ndërsa MBETET PJESËRISHT NË FUQI për pjesën tjetër në shumë prej 135,55 € për periudhën kohore prej 01.01.2022-31.12.2022.

II. OBLIGOHET debitori që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, kreditorit K.U.R. “M...” sh.a, me seli në Mitrovicë në emër të borxhit për shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për periudhën kohore prej 01.01.2023-30.11.2023, t’ia paguaj shumën prej 127.47 €, me kamat ligjor prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbarim, deri në pagesën definitive të borxhit.

III. Në rast ankese kundër këtij aktvendimi urdhërohet pala ankuese që konform nenit 78 par.1 të LPP-së paraprakisht të paguaj garancinë në të holla në shumë prej 127.47 €, si parakusht për parashtrimin e ankesës, në të kundërtën, gjykata konform nenit 78 par.4 të LPP-së do të konsideroj se ankesa nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Kreditori SH.A. KUR “M...” J.S.C. me seli në Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste (Kartelës financiare të konsumatorit) ka parashtruar propozim për përmbarim pranë Përmbaruesit Privat A.M në Vushtrri, me të cilën ka kërkuar që

të detyrohet debitori që në emër borxhit për periudhë prej 01.01.2022 deri me datën 30.11.2023 t'ia paguaj shumën prej 263,02 euro, me kamatë ligjore, vjetore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbauesit privat A.M në Vushtrri, me urdhrin P.nr.03/24 të datës 04.01.2024 e ka lejuar përmbauesin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përmbauesit të përmbauesit privat duke e kundërshtuar në tërësi të njëjtin, me pretendimet se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit është i pabazuar, i paargumentuar, se debitori nuk ka pranuar asnjëherë fatura nga kreditori. Tutje debitori ka shtuar se borxhi i kërkuar nga kreditori është borxh i parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, ashtu që, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit t'a aprovoj si të bazuar dhe urdhrin përmbauesit të përmbauesit privat t'a anuloj në tërësi.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se propozimi për përmbauesin është paraqitur konform nenit 29 të LPP-së, ndërsa lidhur me parashkrimin e borxhit, kreditori ka shtuar se borxhi nuk është parashkruar, ndërsa lidhur me pretendimin e debitorit për mospranimin e faturave, kreditori thekson se nuk kanë pranuar asnjë ankesë nga debitori për këtë çështje duke propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit t'a refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas analizimi dhe vlerësimit të prapësimin të ushtruar nga debitori, gjeti se prapësimi është Pjesërisht i Bazuar.

Lidhur me pretendimin e debitorit se borxhi ndaj kreditorit ka arritur afatin e parashkrimit, gjykata vlerëson se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, pasi që me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në nenin 360 përcaktohet *“afati njëvjeçar i parashkrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë”*, e lidhur me par 2 të kësaj dispozite ku përcaktohet se: 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë, ndërsa që sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.148/2012 është vendosur që: *“Në rastet kur debitori paguan herë pas here një shumë paushalle, mirëpo nuk është specifikuar asnjëherë se ato pagesa me cilin muaj të shpenzimit të energjisë elektrike kanë të bëjnë, nuk mund të thuhet se është ndërprerë parashkrimi i këtij borxhi”*, andaj gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe periudhës kohore për të cilën është propozuar dhe lejuar përmbauesi, erdhi në përfundim se borxhi i cili rrjedh i debitorit, për periudhën kohore prej dt.01.01.2022-31.12.2022 është i parashkruar, ndërsa që nga data 01.01.2023-30.11.2023 borxhi nuk është i parashkruar dhe për të njëjtin lejohet përmbauesi, ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktvendimi, e kjo marrë parasysh se kreditori e ka paraqitë propozimin për përmbauesin në janar të vitit 2024.

Gjykata, lidhur me kamatën ligjore, iu referua nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Ndërsa sa i përket afatit të rrjedhjes se kamatëvonesës, gjykata i referohet mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/20, i dt.01.12.2020, respektivisht par. II, III dhe VI te këtij mendimi juridik dhe gjeti se debitori ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit nga data kur është ushtruar propozimi për përmbauesin e tutje.

Nga shkaqet e theksuara më lart rezulton se Prapësimi i ushtruar nga debitori është pjesërisht në pajtim me nenin 71 par.1 pika.4 të Ligjit të Procedurës Përmbare dhe të njëjtin gjykata e aprovoi pjesërisht si të bazuar, duke zbatuar dispozitën e nenit 73 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CPP.nr.11/24, datë: 16.02.2024

Gjyqtari
Izet Gërguri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.